

Informata mbi grantin

Instrumenti:	Grant Institucional
Organizata Implementuese (përfshirë partnerin nëse është e aplikueshme):	Qendra për Art dhe Komunitet – ARTPOLIS
Kontaktet e organizatës: Adresa, email, telefonat, web faqja	Adresa: Mujo Ulqinaku, 8/8, 10000, Prishtina Email: ojq.artpolis@gmail.com Kontakti Tel: + 383 38 221 512 Web: www.artpolis-ks.com ; www.femart-ks.com
Kohëzgjatja:	Data e fillimit: 01/01/2021 Data e përfundimit: 31/12/23
Buxheti i përkrahur nga programi:	114,900.0 EUR
Buxheti total:	333,382.8 EUR
Shtrirja gjeografike:	Në tërë Kosovën
Grupet e synuara:	Grupi kryesor i synuar janë gratë e reja. Të diskriminuara, të pa privileguara, të nënpërfaqësuar dhe me potencial të konsiderueshëm për të kryer ndryshimin, ky grup i grave dhe vajzave do të jetë në shënjestër aktive dhe të angazhuara në aktivitete të projektit.
Përmbledhje e intervenimit:	Propozimi është përgatitur për të ndihmuar aplikanten të zhvillojë dhe konsolidojë kapacitetet dhe infrastrukturën e tij, ndërsa në të njëjtën kohë të zgjerojë mbështetjen dhe aktivitetet në gjithë Kosovën. Për këtë qëllim, mbështetja e marrë nga EJA do të orientohet kryesisht drejt konsolidimit të shtyllës së parë programore të organizatës që do të thotë: "Bashkë-ndërtimi i lëvizjes feministe duke sfiduar mentalitetin patriarkal në shoqëri përmes artit dhe kulturës", por gjithashtu do të kontribuojë për të përmirësuar qeverisjen dhe menaxhimin e saj të përgjithshëm dhe sigurisht që do të ndikojë pozitivisht edhe në projekte/programme të tjera të organizatës. Qëllimi i Përgjithshëm i mbështetjes së kërkuar është ndërtimi dhe zgjerimi i lëvizjes feministe në Kosovë, me angazhimin e grave të reja nën udhëheqjen e Artpolis.

Bashkëfinancuar nga: